

ADRIANA DUKA

PERSONAZHET SHËTITËS NË TREGIMET E KIM MEHMETIT

Hyrje

Tregimet e Kim Mehmetit janë ndër krijimet më origjinale të letërsisë shqipe bashkëkohore, ato shënojnë kapërcyellin e letërsisë së shkruar përpara '90-s dhe pas saj, duke ruajtur identitetin stilistik. Për rreth dy dekada K. Mehmeti ka botuar dhjetë vëllime me tregime, fillimisht në Maqedoni, mandej në Kosovë e Shqipëri, shumë prej tyre janë përkthyer në gjuhë të huaja.

Mehmeti shmangu shabllonet e letërsisë soc-realiste, gjithashtu dhe strukturat tradicionale të tregimit realist, nga ana tjetër nuk u ndikua as nga tregimi i figurshëm që ishte dominues në Kosovë që prej viteve '50, të shekullit të kaluar. Ai arriti të shkruajë një lloj tregimi ku ndërthuren arketipe, struktura të tregimit fantastik me elemente të reportazhit, opinionit, kronikës, të gjitha këto të fundit si dëshmi faktike e kontekstit historiko-politik, në të cilat kanë jetuar shqiptarët e Maqedonisë.

Një ndër përbërësit më domethënës që e bën të veçantë tregimin e K. Mehmetit është personazhi. Në tregimet e tij, personazhi shndërrohet e shumëfishohet në personazhe, pasi rimerret në tregime të ndryshme. Në letërsisë shqipe, kjo teknikë gjendet rrallë në tregim, mund të përmendim M. Kutelin si shembull, me huazimin e ripërtëritjen e të njëjtave personazhe në prozën e tij. Kjo ndodh sepse përsëritja mbart në vetvete rrezikun e rimarrjes së temave, mesazheve, apo të përdorimit të të njëjtave teknika rrëfimore, kthimin në monotoni për lexuesin. Ripërsëritja e të njëjtit personazh, siç ndodh me K. Mehmetin, në të paktën një tregim në çdo botim apo përmbledhje të re tregimesh, e vendos shkrimtarin në pozitën e dështimit ose të kthimit në konstante stilistike.

Tek K. Mehmeti personazhi kthehet në konstante stilistike, sepse ngërthehet në vazhdimësi me mesazhin që përcjell dhe strukturën rrëfimore. Në tregimet moderne, "përsëritja e personazheve siguron vazhdimësi të subjektit dhe shfaqje të kompleksitetit njerëzor, gjë të cilën

nuk mund ta bëjë një tregim i vetëm.”¹ Kësisoj paraqitja e personazheve nuk është thjesht portretizimi dhe tipizimi, siç gjendet dendur në tregimin realist bashkëkohor shqiptar, por një mundësi për të parë trajta komplekse të të njëjtit individ, me të njëjtin status social, në kontekstet të reja, e njëkohësisht duke ruajtur vazhdimësinë përmes arketypeve dhe personazheve referenciale historike.

Përsëritja e personazheve

Tek tregimet e Kim Mehmetit në shtjellimin e karakterizimit të personazheve theksohen dy veçori, e para është referenca, e cila mund të jetë mitologjike, historike, ajo që Ph. Hamon i quan kategori personazhesh anaforikë², dhe e dyta kontekstualizimi, i njëjti personazh mbart tipare të njëjta ai ndryshon nga tregimi në tregim për shkak se lexuesi e gjen në një kontekst tjetër, të ndryshëm nga i pari.

Ndër personazhet e rimarra dhe më spikatura janë Fata, Kryeplaku, Zani, Balani, Zejnubja, etj. Secili krijon një spektër të gjerë karakteresh, bërthamash narrative, duke e ruajtur protagonizmin edhe kur ka rol episodik.

Mehmeti nuk ka vëllim me tregime ku të paktën një herë të mos dalë si personazh Fata, Fatusha, Fatka. Cilëndo trajtë emri që përdor ky autor, është i njëjti arketip, që zanafillën si personazh e ka në legjendat për mbretin Artur. Fata Morgana, ose Morgan Le Fey, ishte motra e mbretit Artur, magjistare me aftësi të jashtëzakonshme për të ndryshuar rrjedhën e ngjarjeve, fatin e njerëzve. Me të njëjtin emër, nga ana tjetër, njihet fenomeni optik, mirazhi, shndërrimi që u ndodh objekteve. Në tregimet e K. Mehmetit gjenden të dy trajtat, personazhi dhe fenomeni fizik: magjistarja dhe mirazhi.

Konkretisht në tregimin me të njëjtin titull *Fatamorgan*³ zë fill personazhi, i cili del për herë të parë me trajtën e plotë të emrit, në vëllime e tregime të tjera Mehmeti preferon të japë trajtën *Fata*, duke aluduar

¹ P. H. Lattin, *Kate Chopin's Repeating Characters*. MissQ 33,1980, 19-37, f. 36.

² Ph. Hamon, *Statut sémiologique du personnage*. Në: “Poétique du récit”. Seuil, Paris, 1977, f. 122-123, trajton tipologjinë e personazheve dhe klasifikon disa: a) kategoria e personazhe-referencialë: personazhe historikë, mitologjikë, alegorikë, apo punëtorë. b) kategoria e personazheve-vetorë. Shenjohen nga prania në tekst e autorit, lexuesit ose e të deleguarve të tyre: personazhe “zëdhënës”, kori i tragjeditive antike, interlokutorët sokratikë, llafazanë, personazhe të ndryshëm piktorë, shkrimtarë, narratorë, artiste, etj. c) kategoria e personazheve-anaforë.

³ K. Mehmeti, *Dënesje*. Rilindja, Prishtinë, 1988.

shpesh edhe për etimologjinë shqip të emrit, gjithashtu duke e përgjithësuar. Në këtë tregim Fatamorgan shfaqet si plakë në një skenë të shkurtër dialoguese, më tej ngjarja zhvillohet si reflektim për të ardhmen dhe kalohet nga ngjarja konkrete, në mirazh të saj.

Tregimi nis me dialogun e plakës Fatkë dhe nuseve të saj, si episod i rikujtuar dëgjuar prej rrëfimitarit, prandaj shfaqja dhe zhdukja e Fatkës është ndryshim në tregim, kalohet nga ngjarja, në reflektim. Skena e dialogut zëvendësohet me përjetimet e rrëfimitarit në vetë të parë: “mbeta unë vetëm”, tregimi kthehet në eseistikë, meditim për veten, besimin, të ardhmen dhe jetën.

Tregimi është me karakter meditativ, filozofik, këtu Fatka luan rolin e personazhit udhërrëfyes, rol të cilin në disa tregime e luan plaku a plaka, magjistarja e mençur që dikton udhën që duhet të ndjekë, me rrëfimin e historive të shkuara, që janë magjike, të çuditshme, të vërteta, të gjitha i japin përparësi asaj që do të vijë.

Mehmeti preferon që ta shfaqë në tregime të ndryshme urtinë, ta mishërojë tek dikush, shpesh konfliktet e brendshme lindin sepse kujtesa ndeshet me mentorin, udhëheqësin shpirtëror të fisit, etnisë, prandaj këshillat kthehen në dilema dhe janë sfida që personazhi kryesor duhet t'i kalojë.

Portretizim konkret personazhi merr në tregimin *Dita e shën Gjergjit*, magjistarja Fatkë, futet në lumin me gjarpërinj, të cilëve u rrjep lëkurën, i gropos dhe fshatarëve të tmerruar u parashikon një të ardhme të zymtë. Fjalët e saj, fatthënëse në fillim të tregimit, vërtetohen më tej, ajo del si personazh episodik, në hyrje dhe mbyllje të tregimit, me fjalë që të ndërmend më shumë parashikime orakujsh sesa magji shtrigash. Parashikimet e saj janë në vetvete zëri, kthjelltësia dhe ndërgjegjja e banorëve. Ajo u zbulon atyre frikën, u shtie tmerrin e nga ana tjetër u kërkon të falin njëri-tjetrin, të pendohen për të këqijat që kanë bërë në të shkuarën. Fatka nuk ka drojë të thotë atë që mendon, të shprehë e të rrëfejë dyshimet që mendojnë njerëzit, të tregojë dyzimet që ata kanë për të vazhduar bashkëjetesën në një vend ku e ardhmja nuk është asnjëherë e sigurt.

Në këtë tregim atmosfera ngjan e çuditshme, e kjo më së miri e portretizon Fatkën si magjistare në habitatin e vet. Ajo është e vetmja që nuk ka frikë nga shfaqjet e dukurive të tmerrshme për njerëzit e zakonshëm, apo nga ndryshimet fizike, që ndodhin përnjëherësh në fshat.

Tek ky personazh mishërohen tiparet magjike, që mbajnë gjallë kuriozitetin e lexuesit për vazhdimin e rrëfimit.

Nëse në këtë tregim ajo është personazh episodik, në tregimin *Vdekja e magjistares*, Fatka bëhet protagonist e ngjarjes, që është vdekja e saj dhe që mbetet enigma e pazgjidhur deri në fund të tregimit. Të gjitha ngjarjet zhvillohen në një atmosferë fantastike: objektet, veprimet, fjalët dhe gjithçka që ndodh janë pjesë e shformimit të fizikes e metafizikes, që krijojnë tek personazhet e tjerë habi. Të bijtë e rrëfimtari bëhen dëshmitarë të ndodhive, pa ditur të thonë në fund se a ishte e gjitha kjo ngjarje e vërtetë. Në këtë tregim mirëfilli fantastik, Mehmeti e jep të plotë portretin e Fatkës. Në fjalët e saj gjithmonë hamendësohen parashikime të së ardhmes, më së shumti janë të zymta e të kobshme. A vdes apo jo magjistarja, kjo është dilema e rrëfimitarit dhe lexuesit në këtë tregim.

Fatka magjistare është mirëbërësja së cilës i besojnë të gjithë, ajo asnjëherë gjatë jetës së saj nuk ka qenë gruaja, bashkëshortja, apo nëna e zakonshme. Vdekja e saj është shfaqje e mirazheve të shkretëtirës, perceptimi për bukurinë e përjetshme, mister që nuk zhduket me vdekjen fizike. Fatka vdes, por mirazhi i saj jo, prandaj i shfaqet herë mbas here rrëfimtari, në trajta të ndryshme.

Fatka, mund të shihet edhe si shndërrim në figurën e gjyshes, e hasur shpesh në tregimet e Mehmetit. Fatka-gjyshe krijon raportin mes të tashmes dhe fëmijërisë, imazheve të mjegullta dhe realitetit. Perspektiva e rrëfimtari niset nga fëmija dhe fëmijëria, e atij që e mendon gjyshen gjithmonë paksa magjistare. Kësisoj në figurën e gjyshes, huazohen shumë tipare të Fatkës: aftësia për të shëruar, për të ndryshuar rrjedhën e ngjarjeve, për të ndikuar tek të tjerët vetëm me forcën e fjalës.

Fatka gjithashtu shfaqet si figurë e zakonshme njerëzore, me dramën e vet, si shembull përmendim tregimin *Në xhepin e jelekut të gjyshes*. Fatka, vajza më e bukur e fshatit gjendet e vdekur. Për të nderuar kujtimin e saj, i fejuari ngre një vend peligrinazhi, aty gjejnë shërim sëmundjet, gjejnë paqe dhe plotësim të dëshirave. Pas vdekjes emri i saj kthehet në simbol të mirësisë. Në të gjallë historia e saj është tragjike, pjesëmarrëse në luftë, e përdhunuar prej bashkëpartizanëve, asaj nuk i mbetet asgjë për të treguar, prandaj zgjedh vetvrasjen, askush nuk e di arsyen, përveç shoqes së saj. Pas shumë vitesh heshtje, i shoqi mëson të vërtetën, duke vërtetuar se nderimi që ka krijuar për të nuk është iluzion i rrejshëm, por simbol i gruas së virtytshme, që ai njihte.

K. Mehmeti prek një temë tabu, që pak është trajtuar në letërsinë shqipe: përdhunimi dhe denigrimi i grave, vajzave, në kohë lufte, jo prej

armiqve por prej bashkëluftëtarëve e bashkatdhetarëve. Dy vajzat e dhunuara e përballojnë depresionin në mënyra të ndryshme, e ëma e rrëfimitarit për zgjedh të ketë fëmijë me atë që do, t'i kthejë turpin në bashkëjetesë dhunuesit, ndërsa Fatka, më e dobët për ta kapërdirë çnderimin, zgjedh vetëvrasjen.

Pas vdekjes, ajo kthehet përsëri në Fatkën e misterhme, në mirazhin e përhershëm të gruas së cilës nuk ia dimë të gjitha enigmat. Me figurën e saj, shkërmoqet komunizmi, fshehja e situatave dhe prapaskenave të turpshme. Autori në këtë tregim krijon antitezën e figurës së hiperbolizuar në letërsinë shqipe të partizanëve.

Fatka është e pranishme në shumë tregime, sepse mishëron pjesën fshehtësitë e ndërgjegjes njerëzore, frikërat e së shkuarës, dhe pasiguritë për të ardhmen që i pret. Në perspektivën e zymtë të saj, ka shpresë, frika për të vendosur, për të mos u nxituar. "Fatka tallet me njerëzit."⁴

Ajo shfaq optikën e së ardhmes, një vizion realist, i mbështetur mbi të shkuarën, mbi fatin e hidhur të vendasve të përballur me vështirësi. Magjitë e saj nuk kanë të bëjnë me asgjë përrallore, janë pjesë e punës së saj, nuk ka habi në to, ajo është një plakë e mençur që e sheh të ardhmen të zmadhuar në një realitet të rrethuar nga të gjitha anët me të këqija. Ajo nuk është banore e një hapësire vetëm etnike, shkretëtira, lindja e largët janë udhëtime të gjata, pasi si shfaqje mirazhi simbolizon paqartësitë njerëzore, që herë prej padijes, herë prej mungesës së vizionit mund ta çojnë individin dhe etninë në ndërmarrje të gabuara.

Me Fatkën, Fatën, Fatushën, K. Mehmeti ka krijuar personazhin femëror kompleks, të paparashikueshëm, ku bashkohet fantastikja me tragjikën, historia dhe realiteti, e shkuara dhe e tashmja, në përthyerjen që merr figura e gruas, ku mirazhi jo gjithmonë është i vërtetë, e ku e vërteta mund të jetë thjesht mirazh, një përmasë e pakapshme, që më shumë se gjithçka do lirinë.

Kryeplaku përsëritet po aq shpesh sa Fatka, në të tjera tregime të K. Mehmetit. Ai mbart tiparet e sërta të ligjvënësit, nisur gjithmonë nga rregullat e trashëguara brez pas brezi. Figura e tij është e dyzuar, pasi në njërin anë ai shfaqet tek banorët si njeriu që mishëron ligjin dhe rregullin e nga ana tjetër është thyesi i tyre.

"Kryeplaku për fshatarët kishte trajtën e çdo gjëje pa të cilën jeta e tyre do të çrregullohej, do të merrte kahje drejt skëterrës dhe do t'i ngjante

⁴ K. Mehmeti, *Shtëpia në fund të fshatit*. Toena, Tiranë, 2006, f. 44.

fluturimit të plimit të shpendëve që shkojnë andej-këndej të bartura prej erës si të pakohë."⁵

Në tregimin *Fshati pa varreza*, vendimet e kryeplakut, janë paracaktuar shumë kohë më parë, që kur paraardhësit e Kryeplakut vendosën që të mos martohen e të kenë fëmijë, prandaj ai është i detyruar në çdo lloj rrethane e rasti të ndëshkojë. Ata që thyjnë rregullat, tentojnë të largohen, bien ndesh me moralin, apo kërkojnë të trashëgohen, dënohen me vdekje. Në figurën e tij, vihen re gjurmët e dogmave të paraardhësve, kanunit, dokeve, të njerëzve që të vetizohet nga bota, krijojnë një rreth vicioz pa rrugëdalje.

Nga ana tjetër, ky personazh të kujton sjelljen totalitare, asnjë lloj vendimi nuk mund të diskutohet, nuk ka liri mendimi dhe veprimi, nuk ka shpëtim për ata që arratisen. Të gjithë i janë bindur kësaj mënyre jetese, Kryeplaku është rojtari dhe vëzhguesi i gjithçkaje. Megjithatë kjo mendësi dogmatike i çon banorët dhe etninë drejt zhdukjes, ata i qëndrojnë deri në fund vendosmërisë për të mos trashëguar pasardhës, pasi për ta frika e asimilimit është njësoj si vdekja. Totalitarizmi këtu justifikohet me nacionalizmin, i cili për fat të keq nuk është zgjidhja e duhur, kur mungon liria e fjalës dhe e veprimit. Kryeplaku edhe pse e di se në rini të vet ka menduar po njësoj si ata që kërkojnë të largohen, nuk ndryshon asgjë. Ai nuk bëhet kurrë udhëheqës i popullit, mbetet një zbatues cinik i rregullave të padrejta.

Në tregimin *Babai u vonua*, figura e Kryeplakut paraqitet si portretizim i tërthortë prej këndvështrimit të djalit të fqinjit. Vetëm në fund të tregimit lihet të kuptohet se në të vërtetë ai është i biri. Përveç tipareve të ngulitura dhe të pandryshueshme, si respektimi i të parëve dhe dokeve; portreti hijerëndë zbutet me një tis dashamirësie, e parë prej këndvështrimit fëmënor të rrëfimitarit.

Tek *Oda e burrave*, nuk kemi një Kryeplak por disa kryepleq që veprojnë njësoj. Në këtë tregim shfaqet ana e errët e atyre që udhëheqin një vend, del në pah hipokrizia dhe karakteri i dyzuar, ndryshe janë në të vërtetë e ndryshe shfaqen. Balani është i riu të cilin e ftojnë një natë në kuvendin e pleqve, ndërkohë që njëri prej tyre i çnderon nusen, të gjithë e dinë se çfarë ndodh përveç Balanit. Ai e mëson kur fëmija i parë lind, por hesht për t'u hakmarrë ndaj Asimit dhe kryepleqve. Asnjëri prej tyre nuk guxon të tregojë se vrasjen e ka kryer Balani, për të mos nxjerrë përpara fshatarëve turpin e tyre.

⁵ *Po aty*, f. 145.

Hipokrizia e parisë, kryepreqve, që vijojnë të drejtojnë, tregon se sa e gjymtuar është drejtësia, dhe sa e madhe është padrejtësia kundrejt të dobët.

Në të gjitha tregimet⁶, ku Kryeplaku është personazh, ai fsheh një sekret të hershëm të rinisë. Dikur, ai ka qenë i riu që ka qenë më shumë i dhënë pas grave sesa ligjeve, gjatë gjithë jetës vuan pamundësinë për të qenë babai i fëmijës së tij, pengesat për të qenë me gruan që dashuron. Figura dogmatike, e sertë, fsheh gjithmonë një tjetër njeri. Në të gjitha tregimet ku Mehmeti e rimerr këtë personazh, diku qendror, diku tjetër episodik, në të gjitha rastet ai bëhet strumbullari i ngjarjeve. Portreti statik i kryeplakut, është referencë historike shqiptare, e lidhur me kanunin, kur rregulli i pashkruar lidhet me njeriun më shumë se me ligjin, ndërsa K. Mehmeti i jep edhe një trajtë tjetër, atë të njeriut të zakonshëm, që dyzohet mes asaj që është dogmë dhe logjikës.

Duke qenë figurë e rëndësishme për komunitetin e tij, pasi personifikon kanunin, ai gjithashtu mbart mbi vete rrezikun e të mos qenit gjithmonë perfekt. Qenësia e tij është e dyzuar gjithmonë: njeriu publik, gjithmonë në sytë e të tjerëve përballë individit me dëshirat, të metat, të cilat duhet t'i ruajë prej të tjerëve.

K. Mehmeti ruan portretin statik të Kryeplakut, por shemb mitin se njeriu, është edhe fytyra e rregullit dhe ligjit. Ai shpërfaqet në trajta të ndryshme, ka një jetë të mbushur me dobësi, me pengje dhe dështime. Mehmeti ia paraqet të dyja lexuesit, ndërsa në marrëdhëniet ndërmjet personazheve ruhet figura arketip, statike e njeriut-ligj. Kjo tregon se askush nuk mund ta ruajë një komunitet nga shfarosja, për sa kohë ai respekton vendimet e gabuara të marra shumë breza më parë. Figura simbolike nuk mund ta shpëtojë shoqërinë nga prishja e normave morale.

Po njësoj vepron K. Mehmeti me personazhe të tjera si: Balani, Zejnubja, etj. Secili prej tyre rikthehet në tregime me role të ndryshme, p.sh. Balani në tregimin *Dita e shën Gjergjit* është budallai i përçmuar prej të gjithëve, derisa i vjen dita që ata t'i kërkojnë ndihmë pasi është i vetmi që nuk ka frikë kur banorët janë të trembur gjer në palcë. I tallur në tregimin *Oda e burrave*, hakmarrja e tij është përjetimi i katharsisit të shoqërisë.

⁶ Si për shembull: *Oda e burrave*, *Fshati pa varreza*, *Në xhepin e jelekut të gjyshes*, *Babai u vonua*.

Balani del si budallai, i çmenduri, ai që njësoj si magjistarja, po më njerëzor është fytyra e vërtetë e shumë hipokrizive të fshehura, përndjekjes, përçmimit. Balani është portreti i hakmarrjes, viktimës që në fund arrin ta kthejë në cilësi atë që të tjerët e konsiderojnë dobësi të tijën.

Zejnubja, në tregimin *Lulehëna*, është bukuria idilike, që mund të kapet rrallë, në një çast, e më vonë të zhduket. Në tregimin *Lulehëna*, simbolika orientale e përrallore, shfaqet në konceptin për gruan, që mund vetëm ta ëndërrosh e asnjëherë të bëhet e jotja.

Tregimi *Kush të fundosi atje?!* është thirrje drejtuar Zejnubes, të bukurës, të dashurës, asaj që ka qenë dashuria dhe trishtimi i rrëfimitarit, i cili me monologun e vet, i thërret e i drejtohet asaj, e cila nuk do ta dëgjojë kurrë. Krijesat e njohura për njeriun bëhen të çuditshme kur ai rrethohet prej tyre dhe sheh se Zejnubja nuk është jetëgjatë sa dashuria e tij, se fiziku i njeriut shndërrohet në fosile, e mbytur në ujën e pusit.

K. Mehmeti krijon një atmosferë magjike, të cilën më pas e kthen në skena të frikshme, të përgjakshme, të çuditshme, të tmerrshme që herë ngjajnë reale e herë zhduken si pjellë e fantazisë së vetë njeriut, çdo herë në kërkim të së bukurës që mishërohet tek Zejnubja, e jeton pak porsa ajo.

Kërkimi i së bukurës, në tregimin *Flutura* është kërkimi i vetvetes e nis me personazhin që rrëfen historinë në vetë të parë: bashkë me Zejnuben janë nisur nëpër shkretëtirë për haxhillëk. Natën, rrëfimitarit i ndodh të shohë një grua që lind një flutur, gruaja vdes e ngrënë nga zhapinjët që edhe pas vdekjes i shkojnë në varr, e drita zbardh si një mundim i madh, takimi me të tjerë njerëz, humbja e Zejnubes, e kërkimi i gjatë për të. Të gjitha ngjarjet kthehen në një udhëtim të gjatë, fizik dhe shpirtëror, janë një metaforë e vetvetes, vetmisë dhe kërkimit të hapësirës.

*“Njerëzit, e dashur, çdoherë hapërojnë nëpër shkretëtira të pafundme, e kërkojnë veten! Harrojnë se sillen në rreth dhe se shkelin mbi gjurmë të njëjta.”*⁷

Përfundime

Në tregimet e Kim Mehmetit ky lloj personazhi ruan tiparet arketipale dhe sjell një sërë variantesh e karakteresh të larmishme. Rregulli, e bukura, heroizmi, magjia, e ardhmja, e shkuara, ngërthehen e mishërohen në njerëz por gjithsecili prej tyre shpesh përcakton fatin e një shoqërie, e drejton a e çon në udhëkryq, i jep shpresë për të ardhmen, ose e

⁷ K. Mehmeti, *Dënesje*. Rilindja, Prishtinë, 1988, f. 28.

zhduk përgjithmonë. Individit ka një rol të rëndësishëm, duke mos zgjedhur vetminë, fati i tij përcakton gjithë vazhdimësinë e një etnie. Ata që zgjedhin të kundërtën, janë ose heronj ose fatkeqë, në të dyja rastet fundi është tragjik.

K. Mehmeti, ndërton një sistem kompleks personazhesh të rimarra, për të treguar se askush nuk mundet të jetë njësoj në situata të ndryshme. Për të, personazhet nuk mund të jenë protagoniste dhe antoniste, nuk mund të jenë kryesore dhe episodike, secili ruan në rol të rëndësishëm në aspektin narrativ e kuptimor të veprës së tij, duke sjellë befasi, intrigë atëherë kur lexuesi nuk e pret.

Personazhet shëtitëse të tregimeve të K. Mehmetit, paraqesin individin universal që ruan gjithmonë egon për të qenë i lirë, për të mos u asimiluar nga të tjerët, që ruan aftësinë për të pëlqyer të bukurën e për ta kërkuar së pari si motiv tek vetja. Përsëritja e personazheve tregon se, që nga fillimet, përsëriten edhe fenomenet bashkë me ta.

Shëtitja e tyre nëpër tregime është udhëtim i pambaruar dhe rikthim gjithmonë i së keqes dhe së mirës, të zakonshmes dhe të çuditshmes, të frikës, të epshit, të dashurisë, të nderit dhe të përçmimit, të gjitha bashkë bëhen identiteti i mishëruar në personazhe.

K. Mehmeti i ka dhënë tregimit bashkëkohor shqiptar një procedim të ri të personazhit, kështu disa prej tregimeve të tij janë pjesë e rëndësishme e letërsisë shqipe.

BIBLIOGRAFI

- Barthes, R., Kayser, W., Booth, W.C., Hamon, Ph., *Poétique du récit*. Editions du Seuil, Paris, 1977.
- Lattin, P. H., *Kate Chopin's Repeating Characters*. MissQ 33 (1980): 19-37.
- Mehmeti, K., *Pluhuri që mbin*. Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1986.
- Mehmeti, K., *Dënesje*. Rilindja, Prishtinë, 1988.
- Mehmeti, K., *Bolero*. Rilindja, Prishtinë, 1991.
- Mehmeti, K., *Fati*. Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1992.
- Mehmeti, K., *Fati i Fatushes*. FI-GA, Tetovë, 1994.
- Mehmeti, K., *Vdekja e magjistares*. Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1994.
- Mehmeti, K., *Mbledhësit e luleve të vyshkura*. FI-GA, Tetovë, 1995.
- Mehmeti, K., *Lulehëna*. Dukagjini, Pejë, 1997.

Mehmeti, K., *Fshati pa varreza*. Dukagjini, Pejë, 2000.

Mehmeti, K., *Shtëpia në fund të fshatit*. Toena, Tiranë, 2006.

Mehmeti, K., *Në xhepin e jelekut të gjyshes*. Toena, Tiranë, 2007.